

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
 GJYKATA THEMELORE STRUGË
 SU-04.nr.49/22
 20.10.2022
 S t r u g ë

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1, nenit 20 paragrafi 1 alineja 1 dhe nenit 25 nga Ligji për Nëpunësit Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut" numër 43/14, 98/15, 33/15, 06/16, 198/18 dhe 248/18) dhe Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të zbatimit të selektimit administrativ të provimeve, kontrollit të besueshmërisë së dëshmimeve dhe intervistës si dhe mënyra e vlerësimit të tyre dhe numri maksimal i pikëve në procedurën e selektimit në varshmëri nga kategoritë e vendeve të punës si dhe çështje të tjera me procedurën për punësim të nëpunësve gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 236/18), ndërkaq ka të bëjë me vendin e punës nën numrin 1 dhe 2 (nëpunësa gjyqësor), si dhe në bazë të nenit 2, nenit 3 par.3, nenit 21 par.1, nenit 119, nenit 120 dhe nenit 121 nga Ligji për Nëpunësit Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut" numër 43/14, 98/15, 33/15, 06/16, 198/18 dhe 248/18) dhe Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, SU.nr.100/18-2 të dt. 17.01.2019, ndërkaq ka të bëjë me vendin e punës nën numrin 3 (anëtar i policisë gjyqësore)., GJYKATA THEMELORE STRUGË, më datë 20.10.2022,

P u b l i k o n

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR - 1/2022

I.

*për punësim të 2 (dy) nëpunësve gjyqësor në kohë të pacaktuar,
 për vendet e punës si në vijim:*

- 1. Kategorija B, niveli B4, Udhëheqës i seksionit për punë materijale-financiare – 1 (një) realizues – shifra SUD 0101B04002;**

Kushtet e veçanta:

- të paktën 300 kreditë të fituara sipas EKTS-së ose shkalla VII/1 e kryer, Fakulteti Ekonomik ose fakultet tjetër nga fusha përkatëse
- të paktën 4 vite përvojë pune në profesion
- njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin Europian (anglisht, frangjisht ose gjermanisht) dhe
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

- 2. Kategorija G, niveli G1, Referent i pavarur gjyqësor - udhëheqës i shkresores – 1 (një) realizues – shifra SUD 0101G01001;**

Kushtet e veçanta:

- të paktën shkollim i lartë apo shkollim i mesëm
- të paktën 3 vite përvojë pune në profesion
- njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin European (anglisht, frangjisht ose gjermanisht) dhe
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Krahas kushteve të veçanta të theksuara, të parapara me Rregulloren për sistematizim dhe organizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strugë, kandidati për vendin e punës nën numrin 1 dhe 2 duhet t'i plotësojë edhe kushtet e përgjithshme, të përcaktuara në nenin 21 paragrafi 1 nga Ligji për Nënpusa Gjyqësor, edhe atë:

- të jetë shtetas i Republikës të Maqedonisë së Veriut (nënshtetësia),
- në mënyrë aktive t'a përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (vërtetim mjekësor) dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimeve (vërtetim nga gjykata).

Rroga bazë neto për vendin e theksuar të punës nën numër 1 është e paraparë në lartësi prej: 32.445,00 denarë; për vendin e punës nën numër 2 është e paraparë në lartësi prej: 24.461,00 denarë; Kohëzgjatja ditore e punës është 8 orë prej orës 07:30 deri në ora 15:30, kohëzgjatja javore 40 orë – nga e hëna në të premten; kohëzgjatja e marëdhënies së punës është në kohë të pacaktuar.

Kandidatët janë të detyruar të parashetrojnë fletëparaqitje për punësim dhe dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës në origjinal apo kopje të vërtetuara në Noter.

Në fletëparaqitjen, përkrah dëshmive, detyrimisht duhet të përmbahet: emri dhe mbiemri i kandidatit të mbështetura me dëshmi për identifikim personal – letërnjoftim, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i kandidatit, e-mail adresa ose telefoni për kontakt.

Afati për paraqitje është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në gazetata ditore.

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Kandidati i cili ka dhënë të dhëna të rrejshme në fletëparaqitje diskualifikohet nga procedura e mëturjeshe.

Fletëparaqitjen me dëshmitë, kandidatët janë të detyruar që t'a dorëzojnë drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet postës deri në arhivin e Gjykatës Themelore Strugë, Rr. "JNA" pn, e njëjta mund të gjendet në mënyrë elektronike në internet faqen www.osstruga.mk apo të tërhiqet personalisht në hapsirat e gjykatës.

Koha dhe data e mbajtjes së seleksionimit administrativ, provimit dhe intervistës do të shpallen në internet faqen e lartëpërmendur të Gjykatës.

II.

Për punësim të 1- një personi në vendin e punës anëtar i policisë gjyqësore në kohë të pacaktuar

1. Polic gjyqësor, vendi i punës anëtar i policisë gjyqësore, Numri i realizuesëve -1 (një), – shifra SUD 0205B01000;

Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës të Maqedonisë së Veriut;
- në mënyrë aktive t'a përdorë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimeve;

Krahas kushteve të përgjithshme për punësimin e nëpunësit gjyqësor të vërtetuara në nenin 21 paragrafi 1, nga Ligji për Nëpunsa Gjyqësor, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta si në vijim të vërtetuara në nenin 119 nga Ligji për Nëpunsa Gjyqësor dhe nenit 47 të parapara me Rregulloren për sistematizim dhe organizimin të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strugë:

- Të mos jenë më të vjetër se 25 vjeç,
- Të jenë të aftë psikikisht dhe fizikusht për kryerjen e punëve të policisë gjyqësore (konform Urdhëresës për aftësi psikofizike që duhet t'a posedojnë personat të cilët pranohen në punë në policinë gjyqësore G.z. e RM.nr.5/13);
- Të kenë kualifikime profesionale përkatëse të nevojshme për vendin e punës, të paktën shkollim të mesëm, me ose pa përvojë pune,
- Të posedojnë kompetenca përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për vendin e punës.
- -Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,
- -Njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin Europian (anglisht, frangjisht ose gjermanisht) nëpërmjet posedimit të certifikatës ndërkombëtare të pranuar e lëshuar nga testatori zyrtar europian, anëtar i shoqatës ALTE të testotarit europian, ose vërtetim nga institucioni ndërkombëtar, i A1 (A1) niveli i CEFR (CEFR), përkatësisht BULLATS ose Aptis, ose TOEFELL PBT të paktën 310 pikë, TOEFELL CBT të paktën 35 pikë ose TOEFELL IBT të paktën 10 pikë ose DELLF, TCF, TEF; ose Gete certifikatë.

Rroga bazë për vendin e theksuar të punës është: 18.223,00 denarë;
Kohëzgjatja javore 40 orë;
Orari i punës: ndërrimi i 1 nga ora 07-15; ndërrimi i 2 nga ora 15-23; ndërrimi i 3 nga ora 23-07;

Fletëparaqitjen për punësim me dëshmitë e paraqitura për plotësim të kushteve në origjinal apo kopje të vërtetuara në noter, dorëzohen në formë të shkruar nëpërmjet shkresores për pranim të Gjykatës Themelore Strugë, ose nëpërmjet postës në adresë:

Gjykata Themelore Strugë
me shënim: PËR SHPALLJE PUBLIKE NR.1/2022)
Rr. "JNA" PN, Strugë.

Afati për parashtrim të fletëparaqitjeve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore.

Konform nenit 120 par. 3 nga Ligji për Nëpunësa Gjyqësor, verifikimin e kushteve për punësim të anëtarit të policisë gjyqësore e kryen Ministria e Drejtësisë e Republikës të Maqedonisë së Veriut, pa i shkelur kriteret për përfaqësim të drejtë dhe adekuat të qytetarëve të cilët i përkasin të gjitha bashkësive.


Kryetar i Gjykatës.
Ifet Bajramoski